

VENDIM
Nr. 40, datë 14.2.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “EB ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

*(Ndryshuar me vendimin nr. 269, datë 27.10.2025; nr. 14, datë 15.1.2026; nr. 136, datë
21.5.2026)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 191/5 prot., datë 12.2.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EB Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EB Energy” sh.p.k., me *email*-in e datës 31.12.2024, protokolluar në ERE me nr. 2659 prot., datë 31.12.2024, ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, në format elektronik për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier. Ky dokumentacion është depozituar fizikisht, në përputhje me kërkesat e rregullores në protokollin e ERE-s, më datë 6.1.2025.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 19, datë 20.1.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EB Energy” sh.p.k., në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 21.1.2025 dhe 22.1.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.1.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 191/2 prot., datë 23.1.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar.

- Me shkresën nr. 191/3 prot., datë 23.1.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës, duke i kërkuar, gjithashtu, që të bëjë me dije në rast se nga ana e MIE-s ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së depozituar në kuadër të këtij aplikimi dhe të drejtën e shoqërisë “EB Energy” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga MIE deri në këtë vendimmarrje nuk ka pasur përgjigje.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 191/4 prot., datë 31.1.2025.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “EB Energy” sh.p.k.:
- Ka nënshkruar me MIE-n, kontratën nr. 1952 rep., nr. 1263 kol., datë 6.4.2023 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier”;
- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., nr. 5595/3 prot., datë 6.9.2024;
- Ka depozituar vendimin për VNM-në paraprahe, lëshuar më datë 18.7.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i impiantit PV Fier EB Energy”, me fuqi të instaluar 2 mw.
- Në nenin 4 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, nr. 1952 rep., nr. 1263 kol., datë 6.4.2023, përcaktohet se ajo lidhet për një afat 49-vjeçar, nga data e hyrjes në fuqi, me të drejtë ripërtëritjeje. ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, dhe të dokumentacionit të depozituar në ERE, në kuadër të këtij aplikimi, rezulton se shoqëria duhet të vendosë në operim hidrocentralin brenda datës 5.12.2025. Gjithashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kësaj kontrate, vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që me fillimin e operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.
- Rezulton se shoqëria disponon një VNM të vlefshme, deri më datë 18.7.2026, por duke qenë se në referencë të përcaktimeve të kontratës me MIE-n, shoqëria duhet të vendosë në operim centralin brenda datës 5.12.2025, e po ashtu duke marrë në konsideratë një afat 3-mujor që nevojitet për ndërtimin e centralit, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të dokumentojë në ERE fillimin e punimeve brenda muajit shtator të vitit 2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “EB Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
 2. *Shfuqizuar.*
 3. *Shfuqizuar.*
 4. *Shfuqizuar.*
 5. *Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.*
 6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “EB Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a., “FTL” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime

materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti